

Thellimi

Dekreti i Presidentit të Republikës që paraqet Rregulloren që ka të bëjë me disiplinën e akordit të integritetit midis të huajit dhe Shtetit, sipas nenit 4-bis, paragrafi 2, të Tekstit Unik të dispozicioneve lidhur me disiplinën e imgrimit dhe normat mbi situatën e të huajve, sipas dekretit legjislativ të 25 korrikut 1998, n. 286.

Dipartimenti për liri civile e imigrim

www.libertaciviliimmigrazione.interno.it

Ministria e Brendëshme

www.interno.it

<http://accordointegrazione.dlci.interno.it>



AKORDI

PINI III
INTEGRIMIT



Çfarë është akordi i integritit

Akordi është një instrument për të lehtësuar integrimin e qytetarit të huaj.

Me nënshkrimin e akordit i huaji detyrohet të arrijë objektivat specifike të integritit për t'i ndjekur gjatë periudhës në fuqi të lejes së qëndrimit:

- për të arritur një nivel të duhur të njohjes së gjuhës italiane;
- për të arritur njohuri të mjaftueshme dhe kulture civile;
- për të garantuar plotësimin e arësimit të detyrueshëm për fëmijët e mitur.

Shteti angazhohet të mbështesë procesin e integritit të të huajit.

Kush e nënshkruan akordin

I huaji që:

- hyn për herë të parë në territorin italian;
- prezanton një kërkesë për lëshimin e lejes së qëndrimit për një periudhë jo më pak se një vit;
- është në moshë mbi 16 vjeç. Për të miturit me moshë nga 16 deri 18 vjeç akordi nënshkruhet nga prinderit o kush ushtron pushtetin prinderor

Kush nuk duhet të nënshkruajë akordin

Të huajt:

- të sëmurët me patollogji o personat me aftësi të kufizuar si me kufizim të rënda të vetëmjaftueshmerisë o kuptimit gjuhësor e kulturor.
- të miturit jo të shoqëruar
- viktimta e trafikut të personave, të dhunës ose të shfrytëzimit të rëndë;
- të miturit nën moshën 16 vjeç

Ku nënshkruhet

Akordi nënshkruhet në Prefekturë. - Sporteli Unik i imigrimit nga të huajt që hyjnë në Itali për motive pune o për bashkim me një familjar ose në kusturë në rast hyrjeje për motive të tjera.

Çfarë ndodh mbas nënshkrimit

Në aktin e nënshkrimit jepen 16 kredi.

Brënda tre muajve nga nënshkrimi i akordit, i huaji thirret për të marrë pjesë në një sesion të formimit qytetar dhe të informacionit mbi jetën në Itali. Mungesa e pjesëmarrjes shkakton humbjen e 15 kredive.

Ndërprerja o shtyrja e akordit me kërkesë.

Akordi mund të ndërpritet ose të shtyhet me kërkesën e të huajit, duke prezantuar dokumentacionin e duhur, për :

- motive të rënda të shëndetit ose të familjes;
- motive pune;
- Frekuentim kursi ose stazhi formimi, azhurnim të orientimit profesional;
- frekuentim të një stazhi të orientimit
- frekuentim azhurnimi të orientimit profesional;
- studim jashtë shtetit;

Verifikimi i akordit

Një muaj para skadimit të akordit, Sporteli Unik verifikon shkallën e integritit të arritur e i huaji ftohet të prezantojë dokumentacionin për të marrë njohjen e kredive të tjera. Të huajt me vendbanim në provincën e Bolzanos i njihen edhe testet e bëra në gjuhën gjermane. Në rast që nuk ka dokumentacionin e duhur, i huaji mund të kërkojë të bëjë një test për të demonstruar shkallën e njohjes së gjuhës italiane, të kulturës qytetare e të jetës civile në Itali të domosdoshme për plotësimin e akordit.

Rezultati i verifikimit është:

- . MBYLLJA E AKORDIT: i huaji ka arritur një shkallë të përshtatshme të integritit (kredi baraz me 30 o më të mëdha se 30);
- . SHTYRJE E AKORDIT PER NJË VIT: i huaji nuk ka ka arritur një numer kredish të mjaftueshme për mbylljen e akordit (kredi midis 1 dhe 29);
- . PRISHJE E AKORDIT: i huaji nuk ka arritur një gradë të mjaftueshme për integrimin; i hiqet leja e qëndrimit dhe dëbohet nga territori nacional (**kredi baraz me 0 ose më të vogla se 0**);

Konsultimi on-line mbi gjëndjen e akordit

I huaji mund të konsultohet nëpërmjet internetit, në adresën <http://accordointegrazione.dlci.interno.it>, gjatë periudhës që akordi është në fuqi:

- . kredit e arritura;
- . datat e thirrjes për zhvillimin e testit;
- Për këtë qëllim, në momentin e nënshkrimit të akordit, të huajt i jepen instruksionet për hyrjen në funksionet on-line.